



BASHKIA MIRDITË

Rregullore për

**MENAXHIMIN E
PARQEVE DHE
HAPËSIRAVE
PUBLIKE**

BASHKIA MIRDITË

EU4Kids in Rrëshen Realizuar nga projekti EU4Municipalities, projekt i financuar nga Bashkimi Europian



**Funded by
the European Union**





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3705/2 Prot.

Rrëshen me, 10 . 11 . 2023

V E N D I M

Nr. 25 datë 03. 11. 2023

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E PARQEVE DHE HAPSIRAVE PUBLIKE”, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 23, pika 9, dhe neni 54, shkronja “k”, e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Urdhërin e kryetarit të bashkisë me nr. 345, datë 09.10.2023, “Për ngritjen e grupit të punës, për pjesëmarrjen dhe njoftimin e banorëve të zonës dhe grupeve të interesit në konsultim me publikun për miratimin e Rregullores për menaxhimin e parqeve dhe hapsirave publike, bashkia Mirditë, së bashku me projekt-vendimin dhe relacionin nr. 3705 prot, datë 05.10.2023, e paraqitur nga kryetari i bashkisë dhe shqyrtimit në mbledhjen e të komisioneve të këshillit bashkiak të datës 31.11.2023, për t’a kaluar në seancën e këshillit të datës 03.11.2023, për të rekomanduar miratimin, pas diskutimeve në mbledhjen e këshillit bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren për Menaxhimin e Parqeve dhe Hapsirave Publike, të bashkisë Mirditë, bashkëlidhur Rregullorja, pjesë përbërse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë Mirditë, (e gjithë administrata; agjencitë, drejtoritë dhe njësitë administrative).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Rregullorja për Menaxhimin e Parqeve dhe Hapësirave Publike në Bashkinë Mirditë vjen si një nevojë për të adresuar sa më mirë menaxhimin e territorit, duke konsideruar hapësirë publike të gjithë hapësirën e përbashkët të territorit të bashkisë, ashtu siç na mëson tradita shekullore, për: meranë, zabelin, pyllin, bjeshkën, lumin, megjet, por edhe sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Jemi të ndërgjegjshëm që shumëkush konsideron si hapësirë publike vetëm territorin urban të bashkisë, lulishtet dhe trotualet, të cilat duhen menaxhuar dhe kanë strukturat përgjegjëse për këtë punë, por ne duhet të punojmë së bashku që të dalim përtej koncepteve të ngurta dhe të konsiderojmë të shenjtë si hapësirën private, ashtu edhe hapësirën e përbashkët dhe ta shfrytëzojmë atë në mënyrë sa më efektive, për të mirën e të gjithëve.

Është koha që edhe vizitorët e shumtë, që Bashkia Mirditë është e angazhuar të jenë më të shumtë në vitet në vijim, të kenë disa përkufizime të përgjithshme të sjelljes në territorin e bashkisë, në të mirë të territorit, mbrojtjes së rrjedhave ujore e pyjeve nga veprimet që mund të kenë pasoja afatgjata, por edhe në kuadër të mirëqenies së tyre fizike e shpirtërore. Ne duam që të gjithë ata që na vizitojnë, të ikin me dëshirën për t'u rkthyer, ashtu siç e do tradita mirditore.

Duke qenë se territori i Bashkisë Mirditë është shumë i madh dhe administrimi i tij është sfidë më vete, ne besojmë që të gjithë së bashku: punonjësit e administratës, njësive administrative, kryesitë e fshatrave dhe, sidomos, vetë banorët do të bëhemi bashkë për menaxhimin e hapësirës sonë të përbashkët.

Kjo rregullore është hartuar nga Hekuran Koka, në kuadër të projektit EU4Municipalities, financuar nga Bashkimi Europian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë rregullore janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e Bashkimit Europian apo EU4Municipalities.



Përmbajtja

Neni 1. Baza ligjore.....	5
Kreu 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	6
Neni 2. Qëllimi	6
Neni 3. Objekti	6
Neni 4. Interesi i përbashkët.....	6
Kreu 2. MBROJTJA E NATYRËS	6
Neni 5. Mbrojtja e natyrës dhe peizazhit.....	6
Neni 6. Regjimi ujqor.....	6
Neni 7. Mbetjet.....	6
Neni 8. Lënda drusore	7
Neni 9. Bujqësia dhe blegtoia	7
Neni 10. Bimët mjekësore	8
Neni 11. Gjuetia	8
Neni 12. Peshkimi	9
Kreu 3. ORGANIZIMI I FESTAVE DHE LËVIZJES SË TURISTËVE.....	9
Neni 13. Lëvizja e vizitorëve dhe grupeve turistike	9
Neni 14. Shtigjet.....	9
Neni 15. Administrimi i rrugëve dhe lëvizjes së mjeteve	10
Neni 16. Qëndrimi dhe fjetja në natyrë	10
Neni 17. Festat në natyrë	11
Kreu 4. MBROJTJA KUNDËR ZJARRIT	11
Neni 18. Mbrojtja kundër zjarrit	11
Kreu 5. HAPËSIRAT PUBLIKE REKREATIVE	11
Neni 19. Hapësirat rekreative	11
Neni 20. Menaxhimi i hapësirave rekreative	12
Kreu 6. SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE	12
Neni 21. Objekti	12
Neni 22. Përdorimi i hapësirave publike.....	13
Neni 23. Shfrytëzimi i hapësirës për bare, restorante ose vende shërbimi.	13
Neni 24. Shfrytëzimi i hapësirave publike për tregti	13
Neni 25. Procedurat për dhënien e lejes së shfrytëzimit	14
Neni 26. Afatet.....	14



Neni 27. Detyrat e Sektorit të Aseteve Publike	14
Neni 28. Detyrat e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	15
Neni 29. Detyrat e Dejtorisë së të Ardhurave-Taksave	15
Neni 30. Detyrat e Administratorëve	15
Neni 31. Detyrat e Policisë Bashkiake	16
Neni 32. Sektori i transparencës	16
Neni 33. Marrëveshjet.....	16
Neni 34. Mbajtja e dokumenteve.....	16
Neni 35. Sanksionet.....	16
Kreu 7. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	16
Neni 36.	16
Neni 37. Hyrja në fuqi.....	17
Shtojcë 18	
LIGJI Nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”	18
LIGJI Nr. 57/2020 “PËR PYJET”	21
LIGJI Nr. 64/2012 “PËR PESHKIMIN”	28
LIGJI Nr.10253, datë 11.3.2010 “PËR GJUETINË”	28



RREGULLORE E BASHKISË MIRDITË PËR MENAXHIMIN E PARQEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE

Neni 1. Baza ligjore

Këshilli i Bashkisë Mirditë:

Mështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në:

1. ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
2. ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);
3. ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin 110/2015;
5. ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e etikës në Administratën Publike”;
6. ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar);
7. ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (i ndryshuar);
8. ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
9. ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
10. ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”;
11. ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet”;
12. ligjin nr. 64/2012 “Për Peshkimin”;
13. ligjin nr. 10253, dt. 11.03.2010 “Për gjuetinë”;
14. ligjin nr. 8743, dt. 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”;
15. vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” (i ndryshuar);
16. vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 06.08.1993, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”;
17. vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.1.2022, që shpall “Parkun kombëtar Lurë – Mali i Dejës”, (kategoria II), me një sipërfaqe prej 19 288.88 ha;
18. vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 26.1.2022, që shpall Parkun Natyror “Munellë”, (kategoria IV e zonave të mbrojtura) të ekosistemit natyror “Munellë”, me sipërfaqe 20 760.05 ha;
19. VKM nr. 102, datë 15.01.1996, që shpall Bjeshkën e Oroshit si Zonë të Mbrojtur të Resurseve të Menaxhuara (kategoria VI), me sipërfaqe prej 4691.2 ha (pyje dhe kullota);
20. vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 26.1.2022, për Parkun Natyror “Liqeni i Ulzës”, me sipërfaqe 4205.15 ha;

miraton:

RREGULLOREN E BASHKISË MIRDITË PËR MENAXHIMIN E PARQEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE



Kreu 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2. Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mbrojtja, ruajtja, përparimi, promovimi dhe shfrytëzimi i hapësirave publike dhe të përbashkëta, pyjeve, trupave ujore dhe natyrës në territorin e Bashkisë Mirditë.

Neni 3. Objekti

Punonjësit e bashkisë, administrata e njësive, kryesitë e fshtrave, banorët, pronarët dhe/ose përdoruesit e ligjshëm në pasuritë pyjore, personat fizikë dhe juridikë, të cilët kryejnë veprimtari të lejuara, si dhe vizitorët apo turistët janë të detyruar që t'iu përmbahen dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 4. Interesi i përbashkët

Pronarët ose përdoruesit e ligjshëm në pasuritë me interes të përbashkët janë të detyruar që, të lejojnë përfaqësuesit e bashkisë dhe autoriteteve të tjera kompetente të kryejnë aktivitetet e shërbimit publik, me qëllim mbrojtjen e natyrës, hulumtimeve shkencore dhe profesionale, si dhe monitorimin apo mbikqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës.

Kreu 2. MBROJTJA E NATYRËS

Neni 5. Mbrojtja e natyrës dhe peizazhit

1. Në territorin e Bashkisë Mirditë ndalohen, për sa është e mundur, veprimtaritë, të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të natyrës, si dhe veprime, të cilat ndryshojnë pamjen natyrore dhe dëmtojnë vlerat e peizazhit.
2. Përgjashtimisht, bazuar në lejen, e cila lëshohet duke marrë parasysh kushtet për mbrojtjen e natyrës, të cilat përcaktohen nga Qeveria Shqiptare, lejohet ndërtimi apo rindërtimi i objekteve të banimit, tregtisë apo industriale.
3. Për sa është e mundur, të gjitha ndërtimet në territorin e Bashkisë Mirditë i përmbahen traditës, duke mos cenuar vlerat e trashëguara në arkitekturë dhe në mbrojtjen e mjedisit.
4. Dispozitat nga paragrafët 1, 2, dhe 3, të këtij neni zbatohen edhe për ndërtimin dhe vendosjen e objekteve të përkohshme.

Neni 6. Regjimi ujqor

1. Në territorin e Bashkisë Mirditë ndalohen të gjitha aktivitetet, të cilat ndryshojnë regjimin natyror të ujërave, ose ndryshojnë rrjedhat ujore. pa lejen paraprake nga Këshilli Bashkiak.
2. Përgjashtimisht, në bazë të studimit dhe me kushtet për mbrojtjen e natyrës, lejohet ndërtimi i vijave dhe kanaleve vaditëse, kulluese dhe punimet mbrojtëse.
3. Nxjerrja e zhavorrit, lëndëve minerare, si dhe çdo shfrytëzim tjetër i resurseve natyrore ose ndryshimi i peizazhit i nënshtrohet lejeve specifike sipas përcaktimeve ligjore.

Neni 7. Mbetjet



5. Ndalohet çdo veprimtari që shkakton ndotje të ajrit, tokës dhe ujit, e veçanërisht:
 - a. hedhja dhe depozitimi i mbetjeve të shkatuara nga familjet, aktivitetet tregtare, industria, etj.;
 - b. hedhja dhe depozitimi i mbetjeve inerte jashtë vendit të përcaktuar nga bashkia;
 - c. derdhja e lëngjeve dhe përdorimi i mjeteve kimike, të cilat rrezikojnë botën bimore dhe shtazore, domethënë agjentët ndotës të ajrit, tokës dhe ujit.
6. Të gjithë banorët, turistët, tregtarët apo veprimtaritë e tjera janë të detyruar që të gjitha mbetjet t'i hedhin në vendet e përcaktuara dhe shënuara nga bashkia.
7. Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes është e detyruar që të sigurojë dhe shenjojë vendet për hedhjen e mbeturinave në të gjithë territorin e bashkisë, sipas Rregullores për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane dhe kësaj rregulloreje.

Neni 8. Lënda drusore

1. Ndalohet prerja e pyjeve dhe ripyllëzimi. Përrjashtimisht, në bazë të Planit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Pyjeve dhe lejes së bashkisë lejohet prerja sanitare, prerja me karakter kultivues, punët kultivuese dhe ripyllëzimi.
2. Banorëve të zonave malore u lejohet marrja e druve, për të plotësuar nevojat familjare për dru zjarri, prerja me karakter kultivues, punët kultivuese dhe ripyllëzimi, në bazë të programit të mbrojtjes, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pyjeve në zonat e përcaktuara për mbledhjen e druve të zjarrit, si dhe në sezonin e caktuar.
3. Nevojën për dru zjarri për secilën familje e miraton Këshilli Bashkiak, me propozim të Agjencisë së Shërbimit Bujqësor, Veterinar dhe Pyjor, si dhe në bashkërendim me administratorët e njësive përkatëse.
4. Ndalohet prerja dhe tregtimi i lëndës drusore, pa pajisjen me lejet përkatëse.
5. Prerjet sanitare dhe punët e tjera pyjore kryhen në kohën e përcaktuar me Planin Menaxhues dhe Planin Vjetor për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve.

Neni 9. Bujqësia dhe blegtoria

8. Në territorin e Bashkisë Mirditë ndalohet krijimi i sipërfaqeve të reja bujqësore, hapja e rrugëve të reja dhe gjurmimeve të ndryshme, pa lejen paraprake të Këshillit Bashkiak Mirditë.
9. Lejohet ndërtimi dhe themelimi i fermave për mbajtjen e kafshëve shtëpiake dhe të egra, si dhe i veprimtarive të tjera bujqësore dhe blegtorale. Është detyrë e Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare e Pyjore që të sigurojë që, racat e kafshëve dhe farërat që përdoren, të mos jenë specie invaduese dhe që rrezikojnë regjimin aktual të florës dhe faunës.
10. Lejohet bujqësia tradicionale në sipërfaqet ekzistuese bujqësore, si dhe kultivimi i racave vendore të trashëguara.
11. Në territorin e Bashkisë Mirditë, kullotja dhe lëvizja e bagëtisë është e lirë, në respekt të pronës private dhe në mbrojtje të specieve të rrezikuara.
12. Në rastet kur një zonë vlerësohet si zonë e rrezikuar, agjencia, në bashkëpunim me banorët, propozon ndalimin e kullosës dhe lëvizjes së bagëtive deri në rigjenerimin e



zonës. Vendimin për ndalim dhe lirim të zonës për kullotje e bën Këshilli Bashkiak, me propozim të agjencisë.

Neni 10. Bimët mjekësore

1. Në territorin e Bashkisë Mirditë lejohet grumbullimi i bimëve, kërpudhave dhe pjesëve të tyre, si dhe mbledhja e bimëve mjekësore.
2. Në zonat e mbrojtura zbatohen rregullat e përcaktuara nga autoriteti menaxhues për secilën zonë.
3. Është detyrë e Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore që të identifikojë bimët që ndalohet të mblidhen, qoftë ato që rrezikojnë banorët, qoftë ato bimë në rrezik zhdukjeje dhe të organizojë fushata informimi me banorët mbi këto bimë.
4. Në rastet e bimëve apo kërpudhave në rrezik, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore organizon, në bashkëpunim me banorët, fushata për ruajtjen dhe shumimin e florës së rrezikuar.

Neni 11. Gjuetia

1. Në territorin e Bashkisë Mirditë gjuetia dhe aktivitetet e gjuetisë ushtrohen sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10253, dt 11.03.2010, “Për gjuetinë” dhe akteve të tjera nënligjore.
2. Gjuetia ushtrohet vetëm mbi individë të llojeve të faunës së egër, që janë shpallur objekt gjuetie, me vendim të Qeverisë Shqiptare.
3. Janë objekt i gjuetisë individët e llojeve të faunës së egër, lokale ose migratorë, që jetojnë në gjendje të lirë, në kushte natyrore apo që janë riprodhuar, për t’u gjuajtur, në territore të rrethuara, në gjendje gjysmë të lirë a në robëri.
4. Nuk janë objekt i ushtrimit të gjuetisë dhe nuk lejohen të gjuhen individët:
 - b) e llojeve të faunës së egër, të mbrojtur nga konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;
 - c) e llojeve të faunës së egër, që janë të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje dhe që bëjnë pjesë në listën e llojeve të mbrojtura;
 - d) e të gjitha llojeve të shpendëve të egër migratorë, të cilët, pas vlerësimit të popullatave të tyre, rezultojnë shumë të rrallë. Vlerësimi i llojeve migratore është pjesë e inventarizimit.
5. Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore mban dhe azhuron listën e personave që kanë leje për gjueti në të gjithë territorin e bashkisë.
6. Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore siguron publikimin e të gjitha zonave ku ndalohet gjuetia, llojet e kafshëve të cilat nuk lejohet të gjuhen dhe rregulla të përgjithshme të gjuetisë, në faqen e internetit të bashkisë dhe në vende të dukshme përgjatë akteve kryesore, apo në vende të njohura si pika takimi të gjuetarëve.



Neni 12. Peshkimi

1. Në territorin e Bashkisë Mirditë lejohet peshkimi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin” dhe akteve të tjera nënligjore, me kushtet:
 - a. zbatimit, në mënyrë të kujdesshme, të masave që synojnë mbrojtjen dhe konservimin e burimeve të gjallesave ujore, duke ruajtur diversitetin biologjik;
 - b. minimizimit të ndikimit të aktivitetit të peshkimit në ekosistemin ujor;
 - c. zbatimit të një qasjeje me kujdesin maksimal për ruajtjen e ekosistemit gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit;
 - d. vendosjes së parimeve të zhvillimit të aktiviteteve të përgjegjshme të peshkimit;
2. Ndalohet peshkimi në zonat e mbrojtura të peshkimit;
3. Peshkimi në zonat e mbrojtura nga akte të tjera ligjore e nënligjore, (Munella, Oroshi dhe Ulza) i nënshtrohet aktit specifik, sipas rastit.
4. Ndalohet rreptësisht peshkimi me eksploziv, substanca kimike ose çdo mënyrë tjetër që vret, intoksikon apo helmon peshqit dhe ambientin ku jetojnë peshqit.
5. Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore siguron publikimin e të gjitha zonave ku ndalohet peshkimi, llojet e peshqve që nuk lejohet të gjuhen dhe rregulla të përgjithshme të gjuetisë, në faqen e internetit të bashkisë dhe në vende të dukshme, përgjatë akteve kryesore apo në vende të njohura si pika takimi të peshkatarëve.

Kreu 3. ORGANIZIMI I FESTAVE DHE LËVIZJES SË TURISTËVE

Neni 13. Lëvizja e vizitorëve dhe grupeve turistike

1. Në territorin e Bashkisë Mirditë është e mirëpritur lëvizja e lirë e vizitorëve dhe turistëve. Sidoqoftë, kjo lëvizje duhet të bëhet duke iu përmbajtur rregullave të përcaktuara në këtë rregullore dhe përgjithësisht në respektim të masave të sigurisë për lëvizjen në terrene të ndryshme.
2. InfoKulla organizon lëvizjen e vizitorëve dhe turistëve me punonjësit e saj në territorin e bashkisë, sipas grafikëve të përcaktuar më parë.
3. Të gjithë shoqëruesit e grupeve të vizitorëve në territorin e Bashkisë Mirditë duhet të jenë persona të autorizuar më parë nga InfoKulla dhe duhet të ruajnë kontaktet me InfoKullën, përgjatë gjithë itinerarit të tyre.
4. InfoKulla lëshon leje për guida turistike të specializuar për territorin e Bashkisë Mirditë.
5. InfoKulla bashkërendon punët edhe me entet e tjera certifikuese të guidave turistike që duan të mbulojnë territorin e Bashkisë Mirditë, në mënyrë që të gjithë vizitorëve t’u garantohet siguria dhe komoditeti i vizitës.

Neni 14. Shtigjet



1. Lëvizja e vizitorëve dhe turistëve në zonat malore këshillohet vetëm në zonat dhe shtigjet, të cilat janë të shenjëzuara dhe të destinuara për vizitorë.
2. Shtigjet e këmbësorëve dhe vendet, të cilat mund të vizitohen, i përcakton Sektori i Turizmit/ Infokulla, në bashkërendim me administratorët lokalë.
3. Infokulla është e detyruar që të shenjëzojë në mënyrën e duhur shtigjet e këmbësorëve dhe vendet që mund të vizitohen.
4. Administratorët e njësive duhet të monitorojnë shtigjet dhe të njoftojnë në çdo rast dëmtimi apo tjetërsimi InfoKullën.
5. Lëvizja e vizitorëve jashtë zonës dhe shtigjeve të përcaktuara duhet të lejohet vetëm nën përcjelljen/njoftimin për itinerarin të punonjësve të autorizuar nga bashkia.

Neni 15. Administrimi i rrugëve dhe lëvizjes së mjeteve

1. Parkimi i automjeteve në territorin e Bashkisë Mirditë lejohet vetëm në vendet e parapara dhe të shenjëzuara, apo sipas përcaktimeve në kodin rrugor.
2. InfoKulla, në bashkërendim me administratorët lokalë, identifikon vendet për ndalim të përkohshëm apo parkim përgjatë akseve rrugore dhe pranë pikave të përcaktuara për qëndrim e fjetje të vizitorëve.
3. InfoKulla përcakton edhe pikat panoramike dhe, në bashkërendim me administratorët lokalë dhe Agjencinë e Rrugëve Rurale, përcakton dhe shenjëzon vendet për ndalimin e automjeteve, pa penguar qarkullimin në rrugë.
4. Vendet e përcaktuara për ndalim duhet të pajisjen edhe me infrastrukturën e duhur, për të mos krijuar ndotje të ambientit dhe shqetësim për banorët.

Neni 16. Qëndrimi dhe fjetja në natyrë

5. Qëndrimi dhe bujtja e vizitorëve (mysafirëve) në territorin e Bashkisë Mirditë lejohet vetëm në vendet e parapara dhe të shenjëzuara.
6. Vendet për qëndrim dhe fjetje në natyrë i përcakton InfoKulla, në bashkërendim me administratorët lokalë.
7. InfoKulla ka detyrë të shënojë në terren dhe në hartë të gjitha pikat ku lejohet pikniku apo qëndrimi dhe fjetja në natyrë e turistëve dhe vizitorëve.
8. InfoKulla duhet të shënojë vendqëndrime në të gjitha akset kryesore të destinuara për vizitorë.
9. Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes pajis me sistemin e duhur për piknik dhe pika për grumbullimin e mbetjeve, të gjitha pikat e shënuara në hartë.
10. Administrata e Njësive Administrative ka detyrë njoftimin e organeve përgjegjëse, për largimin në kohë të mbetjeve të krijuara dhe mbajtjen pastër të pikave të shënuara.
11. Vizitorët kanë për detyrë mbajtjen pastër të pikave ku qëndrojnë. Rekomandohet që mbetjet e krijuara t'i transportojnë në pika grumbullimi sa më afër qytetit, kur është e mundur, dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet t'i hedhin ato jashtë pikave të përcaktuara qartë.
12. Sanksionet për ndotësit përcaktohen në paketën fiskale të Bashkisë Mirditë.



Neni 17. Festat në natyrë

13. Territori i Bashkisë Mirditë paraqet vlera të theksuara natyrore dhe si i tillë është i këshillueshëm për organizimin e festave dhe eventeve në natyrë.
14. Për të garantuar mbrojtjen e territorit, sigurinë dhe shëndetin e pjesëmarrësve, aktivitetet festive lejohen vetëm në vendet e parapara dhe të shenjëzuara paraprakisht.
15. InfoKulla, me pëlqim të bashkisë, ministrisë, i përcakton llojet e aktiviteteve rekreative dhe vendet e parapara për aktivitete rekreative.
16. Administratorët janë të detyruar të sigurojnë që vendet e parapara për festa janë shenjuar në mënyrën e duhur.
17. Aktivitetet rekreative i organizon bashkia, ose persona që autorizohen nga bashkia.
18. Bashkia është e detyruar të lejojë organizimin e festave nga grupe komunitare, duke iu përmbajtur të gjitha rregullave të përcaktuara në këtë rregullore dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore, që garantojnë sigurinë e pjesëmarrësve dhe mbrojtjen e ambientit.

Kreu 4. MBROJTJA KUNDËR ZJARRIT**Neni 18. Mbrojtja kundër zjarrit**

1. Me qëllim të marrjes së masave për parandalimin e zjarreve në territorin e Bashkisë Mirditë, sigurohet:
 - a) shërbimi i përhershëm për vëzhgim dhe lajmërim, nga rrjeti i banorëve, kryetarëve të fshatrave, administratorëve dhe shërbimit zjarrfikës;
 - b) mbajtja e rrugëve dhe shtigjeve nëpër pyje dhe tokë pyjore të kalueshme;
 - c) gatishmëria e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe avancimit teknik të përhershëm të tyre;
 - d) ndalimi i ndezjes së zjarrit jashtë vendbanimeve dhe vendeve, të cilat janë veçanërisht të përcaktuara dhe të shenjuara për atë qëllim.
2. Masat për mbrojtjen kundër zjarrit i orientojnë punonjësit e MZSH-së, në bazë të akteve të veçanta dhe programit operativ.
3. Masat për mbrojtjen kundër zjarrit janë të detyruar t'i zbatojnë të gjithë personat juridikë dhe fizikë.
4. Ndalohet djegia e barit, hamulloreve dhe livadheve, pa marrjen e të gjitha masave mbrojtëse dhe lajmërimin paraprak të autoriteteve.

Kreu 5. HAPËSIRAT PUBLIKE REKREATIVE**Neni 19. Hapësirat rekreative**

Të gjitha hapësirat publike në Bashkinë Mirditë i nënshtrohen disa rregullave bazë:

1. Të gjithë qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, arsimit, etnisë, gjendjes ekonomike e sociale, bindjeve politike e fetare, etj.;



2. Të gjithë përdoruesit e hapësirave publike, këndeve të lojërave, këndeve të forcës, duhet të veprojnë, duke iu përshtatur dhe duke respektuar si parësor interesin e publikut.
3. Të gjithë përdoruesit, punonjësit dhe vizitorët e hapësirave publike përdorin hapësirat, duke respektuar parimin e trashëgimisë së hapësirës publike, duke respektuar përdoruesit e mëpasshëm të këtyre hapësirave.
4. Punonjësit e bashkisë dhe menaxhuesit e hapësirave publike detyrohen të trajtojnë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjithë subjektet me të cilët hyjnë në marrëdhënie, për shkak të detyrave apo kompetencave të tyre, duke zbatuar me rigorozitet parimet e etikës në administratën publike;
5. Të gjithë sektorët, nëpunësit e administratës, punëtorët, banorët e lagjeve dhe vizitorët duhet të sigurojnë bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Neni 20. Menaxhimi i hapësirave rekreative

Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes sigurohet që:

1. të mirëmbajë rregullisht këndet e lojërave, këndet e forcës dhe terrenet sportive;
2. të monitorojë sigurinë dhe funksionalitetin e këndeve të lojërave, këndeve të forcës dhe terreneve sportive;
3. të ndërhyjë në përmirësim të infrastrukturës dhe pajisjeve në këndet e lojërave, këndet e forcës dhe terreneve sportive, brenda territorit të Bashkisë Mirditë;
4. të evidentojë dhe inventarizojë këndet e lojërave, këndet e forcës dhe terrenet sportive të ndërtuara prej vitesh, brenda territorit të bashkisë;
5. të bashkëpunojë me të gjithë sektorët dhe administratorët e njësive dhe të japë asistencë teknike në përzgjedhjen e hapësirave të reja dhe hartimin e projekteve për kënde lojërash, kënde force dhe terrene sportive, brenda territorit të Bashkisë Mirditë;
6. të përpilojë nevojat për pajisje dhe aksesore për këndet e lojërave, këndet e forcës dhe terrenet sportive dhe të hartojë nevojat për projekt-buxhetin vjetor të agjencisë, me shpërndarje të drejtë në kohë;
7. të monitorojë zbatimin e masave për sigurimin teknik gjatë kryerjes së shërbimeve në këndet e lojërave, këndet e forcës dhe terrenet sportive, duke mbrojtur në këtë mënyrë qytetarët dhe punonjësit.

Kreu 6. SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE

Neni 21. Objekti

1. Hapësirë publike është hapësira e jashtme, si: trotuari, sheshi, lulishtja, parku dhe të tjerë të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht regjimit juridik të tokës dhe përtej



përcaktimeve të pronës publike, sipas Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

2. Objekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha hapësirat publike në pronësi të Bashkisë Mirditë.
3. Harta e hapësirave publike është sipas parashikimeve të planit të përgjithshëm vendorë.
4. Miratimi dhe/apo ndryshimi i planit për shfrytëzimin e hapësirave publike bëhet me vendim të kryetarit të bashkisë.

Neni 22. Përdorimi i hapësirave publike

5. Hapësira publike është pronë e përbashkët, që i përket komunitetit ku jetojmë dhe të gjithë ne jemi të barabartë kundrejt përdorimit të saj.
6. Është e ndaluar zënia e hapësirës publike në mënyrë të përkohshme dhe përhershme, me çfarëdo lloj objekti, mbi ose nën të, pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.
7. Lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike jepen për një periudhë jo më të vogël se 6 muaj dhe jo më të madhe se 1 vit dhe kanë të drejtë rinovimi.
8. Lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike jepen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Neni 23. Shfrytëzimi i hapësirës për bare, restorante ose vende shërbimi

Subjekti, në përputhje me rregulloren dhe ligjet në fuqi, duhet të shfrytëzojë hapësirën publike, sipas miratimit të bërë. Detyrimet e subjektit përdorues të hapësirës publike janë:

- a. të riparojë, me shpenzimet e veta, të gjitha dëmtimet që rezultojnë nga përdorimi ose keqpërdorimi i hapësirës publike të dhënë;
- b. të sigurojë, me shpenzimet e veta dhe në kushte optimale, sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim dhe atë rreth saj si nga ana e pastërtisë, ashtu dhe funksionalitetit;
- c. të kujdeset që objektet e vendosura në sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim të jenë në gjendje të mirë si nga ana funksionale, ashtu dhe ajo estetike;
- d. të përdorë hapësirën publike në mënyrë të tillë që të mos kufizojë, shkaktojë dëme ose të shkelë të drejtat e paleve të treta;
- e. të shmangë krijimin e situatave të rrezikshme ose të pengimit të qarkullimit të mjeteve dhe kalimit të këmbësorëve;
- f. të mos shfrytëzojë hapësirë më të madhe se fasada e ambientit që ai disponon;
- g. të bëjë pagesën e tarifës, brenda afateve të përcaktuara;
- h. në momentin që subjekti nuk ka më të drejtë për shfrytëzimin e hapësirës publike, si rrjedhojë e moszbatimit të detyrimeve ose nëpërmjet kërkesës së tij, duhet ta kthejë atë hapësirë në gjendje funksionale, siç ishte para marrjes në dorëzim.

Neni 24. Shfrytëzimi i hapësirave publike për tregti

Shfrytëzimi i hapësirës publike, për tregtimin e artikujve të ndryshëm, biznese të tjera të ngjashme apo shitës ambulantë lejohet, si më poshtë:



- a. përdorimi i hapësirës nga shitësit ambulantë lejohet vetëm në rastet kur ata janë të grupuar në tregje, apo hapësira të përcaktuara nga pushteti lokal;
- b. nuk lejohet vendosja e kioskave, përveç vendeve të përcaktuara nga autoriteti vendor;
- c. aprovimi i vendndodhjes do shoqërohet me modelin e kioskës respektive, si dhe detyrimet që përfituesi do të ketë, për përdorimin e kësaj hapësire publike;
- d. këto biznese (dyqan, tregtimi i artikujve të ndryshëm, biznese të ngjashme) janë të detyruara të kryejnë veprimtarinë e tyre brenda hapësirës, ambientit që zotërojnë, (kanë në përdorim), duke mos cenuar, në asnjë mënyrë, hapësirën publike;
- e. ekspozimi i produkteve të tregtuara duhet të bëhet vetëm brenda fasadës së ambientit ku biznesi ushtron aktivitetin dhe jo jashtë saj;
- f. gjithashtu, për çdo element të shtuar të fasadave respektive, që është pjesë e hapësirës publike, sikurse janë: tenda, çadra, reklama etj., nevojitet leje nga autoritetet përkatëse.

Neni 25. Procedurat për dhënien e lejes së shfrytëzimit

1. Subjektet e interesuara duhet të paraqesin në zyrën me një ndalesë (Z1N) dokumentet e mëposhtme, për fillimin e procedurave të dhënies së lejes së shfrytëzimit të hapësirës publike:
 - a) fotokopje të mjetit identifikues;
 - b) kërkesë për pajisjen me leje shfrytëzimi (formular nr.1);
 - c) certifikatën e regjistrimit të subjektit;
 - d) vërtetim që subjekti nuk ka detyrime vendore të palikujduara;
 - e) dy foto të këndeve të ndryshme të hapësirës, ku të kuptohet fasada e ambientit, si dhe hapësira para saj (trotuari).
9. Në rastet kur aplikimi për pajisje me leje shfrytëzimi të hapësirës publike ka mangësi në dokumentacion leja refuzohet.
10. Kërkesat paraqiten pranë zyrës me një ndalesë, pranë Bashkisë Mirditë.
11. Subjekti pajiset me leje shfrytëzimi, pasi të kryejë detyrimet e pagesave për hapësirën që kërkon të marrë në shfrytëzim.

Neni 26. Afatet

12. Bashkia Mirditë del me vendim brenda 10 ditëve për dhënien apo jo të shfrytëzimit të hapësirave publike.
13. Afati 10-ditor përjashtohet atëherë kur kërkuesi nuk plotëson detyrimet financiare dhe në rastet kur zonat e kërkuara nuk janë zona me studime plani.
14. Moszbatimi i afateve konsiderohet shkelje dhe shoqërohet me masë disiplinore “shkelje e lehtë”.

Neni 27. Detyrat e Sektorit të Aseteve Publike



15. Sektori i Pasurive të Paluajtshme, Aseteve Publike dhe Borxhit realizon planin e shfrytëzimit të hapësirës publike në të gjithë territorin e bashkisë ose në një pjesë të saj, të specifikuar në këtë rregullore dhe që nuk bie në kundërshtim me të.
16. Ne rastet kur paraqiten kërkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike në zona që nuk janë përfshirë në plane, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit merr në shqyrtim brenda 15 ditëve kërkesat dhe në rastet kur, kërkesa nuk bie në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe këtë rregullore, i propozon Kryetarit të Bashkisë që kjo zonë të përfshihet në planin e shfrytëzimit të hapësirave publike.

Neni 28. Detyrat e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

17. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit shqyrton kërkesën, nëse ajo është në përputhje me këtë rregullore dhe ligjet në fuqi.
18. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, pasi verifikon kërkesën nëse është në përputhje me rregulloren, përcaktimet dhe specifikimet teknike, pjesë e kësaj rregulloreje, prodhon hartën, të cilën ia dërgon Drejtorisë së të Ardhurave-Taksave.
19. Në momentin e dhënies së lejeve të shfrytëzimit, kjo u përcillet dhe u komunikohet zyrtarisht administratorëve të njësive administrative.

Neni 29. Detyrat e Drejtorisë së të Ardhurave-Taksave

20. Drejtoria e të Ardhurave-Taksave verifikon që subjekti nuk është debitor për detyrimet vendore.
21. Drejtoria e të Ardhurave-Taksave faturon detyrimet për hapësirat dhe siguron që fatura të shlyhet përpara dhënies së lejes së shfrytëzimit.
22. Drejtoria e të Ardhurave-Taksave kryen inspektimet veçmas ose në bashkëpunim me administratorët.
23. Inspektorët e terrenit të Drejtorisë së të Ardhurave-Taksave aplikojnë gjokat për çdo subjekt apo individ në rastet e shkeljeve të konstatuara nga ana këtyre të fundit.

Neni 30. Detyrat e Administratorëve

24. Administratorët e njësive administrative do të sigurojnë që subjektet të zbatojnë me korrektësi sipërfaqen të cilën kanë marrë në përdorim.
25. Administratorët e njësive administrative dhe inspektorët e të ardhurave kryejnë inspektime dhe mbajnë procesverbal konstatimi të situatës në tërësi, jo më pak se 1 herë në muaj, duke evidentuar ato subjekte që kanë probleme.
26. Administratorët e njësive administrative raportojnë pranë kryetarit për çdo rast të zënies së hapësirave publike në mënyrë jo të ligjshme.
27. Moskryerja e këtyre detyrimeve konsiderohet shkelje për administratorët e njësive administrative dhe inspektorët e të ardhurave.



Neni 31. Detyrat e Policisë Bashkiake

28. Policia bashkiake ka detyrë të jetë, në çdo rast, në mbështetje të administratorëve apo inspektorëve të të ardhurave, në rastet kur këta të fundit e shohin të nevojshme prezencën e saj.
29. Policia bashkiake, në rastet e shkeljeve të lejes së shfrytëzimit të hapësirave publike ka detyrën të lirojë sheshet dhe hapësirat publike.
30. Policia bashkiake aplikon gjobat për çdo subjekt apo individ, në rastet e shkeljeve të konstatuara nga ana e këtyre të fundit.

Neni 32. Sektori i transparencës

Sektori i transparencës bën publikimin në faqen zyrtare të lejes së shfrytëzimit të hapësirës publike dhe hartën e vendndodhjes.

Neni 33. Marrëveshjet

31. Marrëveshja, e cilat lidhet me subjektin kërkues dhe Bashkisë Mirditë, ka si qëllim përcaktimin e kriterëve të bashkëpunimit në fushën e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe shërbimit të hapësirave publike në shfrytëzim dhe përreth zonës në të cilën ushtrohet aktiviteti.
32. Kjo marrëveshje bëhet sipas rëndësisë së zonave dhe kategorive, të përcaktuara në këtë rregullore.
33. Modelet tip të marrëveshjeve përcaktohen me vendim të kryetarit të bashkisë.

Neni 34. Mbajtja e dokumenteve

1. Subjekti i pajisur me lejen e shfrytëzimit duhet t'i mbajë dokumentet në ambientet ku ushtron aktivitetin. Mosmbajtja e dokumenteve në mënyrë të përsëritur konsiderohet si shkelje dhe ndëshkohet me gjobë. Përsëritja në mënyrë të vazhdueshme e shkeljes bëhet shkak për heqjen e lejes së shfrytëzimit.

Neni 35. Sanksionet

1. Në momentin e konstatimit të zënies së hapësirës publike, subjekti gjobitet me gjobë, sipas kundravajtjes përkatëse, të përcaktuar në Paketën Fiskale në fuqi të Bashkisë Mirditë

Kreu 7. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**Neni 36.**

1. Bashkia Mirditë do të marrë të gjitha masat që të plotësojë ose përshtasë aktet e tjera, sipas kësaj rregulloreje, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.



2. Të gjithë sektorët e prekur nga kjo rregullore kanë afat 90 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje që të kryejnë shenjzimet dhe plotësimin me informacionin e paraparë sipas kësaj rregulloreje.

Neni 37. Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.



Shtojcë

Ekstrakte nga disa prej ligjeve që qeverisin parqet, hapësirat publike dhe ambientet çlodhëse në nivel qeverisje vendore.

LIGJ Nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

Neni 8. Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre, për çdo çështje që nuk u ndalohe me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.
2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.

Neni 9 - Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës:

- a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;
- b) bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra;
- c) krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;
- d) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre.
- e) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

1.2. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

- a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- b) e drejta e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:



- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:

- a) vendosin emërtimet e territoreve, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj;

Neni 19 - E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore.

2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 22 - Parimet për ushtrimin e funksioneve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.

Neni 23 - Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

- 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.
- 4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
- 5. Ndrëhimin e mjediseve publike.
- 8. Shërbimin e dekorit publik.
- 9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
- 10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
- 14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.



Neni 25 - Funksonet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Neni 26 - Funksonet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Neni 27 - Funksonet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 29 - Funksonet e bashkive në fushën e sigurisë publike

Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.
4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.



Neni 32 - Administrimi i shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë.
2. Mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 54 - Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Neni 66 - Detyrat e administratës së njësisë administrative

Administrata e njësisë administrative kryen këto detyra:

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- b) mbikqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;

Neni 71 - Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit

1. Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.
2. Bazuar në vendimin e kryetarit të bashkisë, kryetari ose kryesia e fshatit mund të kryejë edhe detyrat si më poshtë:
 - ç) kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, si dhe të burimeve natyrore.

LIGJ Nr. 57/2020 PËR PYJET**Neni 3 - Përkufizime**

5. "Bashki" është njësi e vetëqeverisjes vendore, që ka në pronësi sipërfaqe të fondit pyjor brenda kufijve territorialë administrativë të saj, e cila është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor publik.



9. “Dëmtim i pyllit dhe mjedisit pyjor” janë dëmtime me pasojë humbjen e funksioneve të pjesëve të pyllit ose mjedisit pyjor dhe prishjen e ekuilibrave biologjikë natyrorë, si rezultat i ndërhyrjeve nga njeriu ose nga faktorë të tjerë natyrorë.

15. “Ekosistem pyjor” është një kompleks dinamik i bashkësive të kafshëve, bimëve e mikroorganizmave dhe mjedisit të tyre abiotik, që bashkëveprojnë si një njësi funksionale, ku drurët janë komponenti kyç i sistemit dhe ku njerëzit, me nevojat e tyre kulturore, ekonomike, sociale dhe mjedisore, janë pjesë integrale e ekosistemeve pyjore.

30. “Mundësia vjetore e shfrytëzimit” është sasia e vëllimit drusor, e përcaktuar në një plan mbarështimi të miratuar, që mund të pritët çdo vit ose në mënyrë periodike në një ekonomi pyjore përgjatë një periudhe të dhënë. Pjesë e mundësisë vjetore të shfrytëzimit bëhen edhe sasitë e materialit drusor të dëmtuar për shkaqe natyrore dhe/ose të tjera (furtuna, ngrica, dëbora, zjarre, sëmundje, dëmtues etj.), të cilat kanë prioritet shfrytëzimi, duke mbajtur në ekuivalencë mundësinë vjetore të planifikuar nga planet e mbarështimit.

34. “Pasuri pyjore” është tërësia e elementeve natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlera të përdorshme për nevojat e shoqërisë, në të cilat përfshihen toka, drurët, uji, bimësia e shumëllojshme jopyjore dhe gjallesat e egra.

60. “Shërbimet e ekosistemit” janë përfitimet që marrin njerëzit nga ekosistemet dhe përfshijnë: shërbime të furnizimit për ushqim dhe ujë; shërbime rregullatore për parandalimin e përmytjeve, thatësisë, sëmundjeve, degradimit të tokës (mbrojtja e tokës nga gërryerja, rrëshqitjet, mbrojtja e tokave bujqësore nga erërat, përthithja e karbonit, zhvillimi i faunës), të cilat lidhen edhe me ndryshimet klimaterike dhe mbrojtjen e biodiversitetit; shërbime mbështetëse për tokëformimin dhe ciklin e lëndëve ushqyese; shërbime kulturore që lidhen me rekreacionin dhe përfitime të tjera jomateriale.

63. “Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve” është procesi i administrimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, në mënyra dhe intensitete të tilla që të ruajnë larminë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjera, si në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe botëror.

Neni 7 - Grupet e interesit në sektorin e pyjeve

1. Grupet kryesore të interesit në sektorin e pyjeve përfshijnë institucionet qendrore dhe vendore, të cilat kanë përgjegjësi për zhvillimin e sektorit dhe mbarështimin e pyjeve, pronarët privatë të pyjeve, organizimet e shoqërisë civile, që operojnë në fushën e mjedisit dhe të pyjeve, profesionistët e fushës, shoqatat apo format e tjera të organizimit kolektiv të përdoruesve të pyjeve, bizneset që shfrytëzojnë produktet pyjore, si dhe komunitetet në zonat rurale, jeta e të cilëve është drejtpërsëdrejti e lidhur me pyjet.

2. Grupet e ndryshme të interesit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë e tyre në funksion të zhvillimit të sektorit, si dhe ofrojnë kontributin në përputhje me përcaktimet ligjore dhe interesat e tyre të ligjshme përgjatë proceseve të hartimit dhe të zbatimit të kuadrit ligjor dhe dokumenteve planifikuese për pyjet.

3. Institucionet përgjegjëse për pyjet garantojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të interesit për rëndësinë e pyjeve, politikat dhe masat e ndërmarra në lidhje me mbrojtjen, administrimin dhe mbarështimin e tyre. Agjencia garanton konsultimin, koordinimin dhe



angazhimin e grupeve të interesit në nivel kombëtar, duke harmonizuar përpjekjet dhe kontributin e tyre drejt përmirësimit të gjendjes së pyjeve.

Neni 12 - Të drejtat dhe detyrimet mbi pyjet

1. Për shkak të vlerës dhe rëndësisë, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla. Funkzioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre “pasuri kombëtare” dhe interesit publik që ato përmbushin.

2. E drejta e pronësisë mbi fondin pyjor kombëtar nënkupton mundësinë për të gëzuar dhe disponuar pjesë apo sipërfaqe të fondit pyjor kombëtar, brenda kufizimeve të vendosura në këtë ligj, në përputhje me funksionin dhe destinimin e fondit pyjor kombëtar. Sipas pronësisë, fondi pyjor kombëtar ndahet në fond pyjor publik dhe privat:

a) fondi pyjor në pronësi publike përfshin të gjitha kategoritë e fondit pyjor kombëtar, që janë në pronësi të institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor dhe ndahet në fond pyjor në pronësi të bashkive për sipërfaqet brenda kufijve të tyre administrativë, si dhe në fond pyjor në pronësi të ministrisë, ku përfshihen pyjet në zonat e mbrojtura, që gjenden nën administrimin e agjencisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura;

3. b) bashkitë përdorin pjesë të të ardhurave të realizuara nga shfrytëzimi i fondit pyjor brenda kufijve të tyre administrativë për të financuar programe sociale në ndihmë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

4. a) familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale kanë të drejtën e përdorimit të sipërfaqeve të fondit pyjor kombëtar në afërsi të fshatit për përmbushjen e nevojave vetjake;

Neni 16 - Strukturat vendore përgjegjëse për pyjet

1. Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.

2. Strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale.

3. Bashkitë ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor, duke garantuar një raport të drejtë gjinor. Numri i 15 punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor si më poshtë:

- a) një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta;
- b) një specialist pyjesh për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulëta dhe shkurret.



4. Emërimi në detyrë i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet bëhet nga kryetari i bashkisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil. Kriteret e përgjithshme të profesionalizmit për emërimin e punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet hartohen nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet dhe miratohen nga ministri.

5. Inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki, bazuar në natyrën e veçantë të funksionit që realizojnë dhe përgjegjësinë e përbashkët për përmbushjen e tij, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet.

6. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit dhe procesit të inspektimit, inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki raportojnë në përputhje me linjën dhe hierarkinë administrative përpara drejtuesit të strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe, kur kërkohet, pranë agjencisë dhe institucioneve të tjera të përcaktuara në këtë ligj.

7. Strukturat komunitare në fshat, nën koordinimin e bashkisë, bashkëpunojnë me strukturat vendore përgjegjëse për pyjet, me strukturat vendore të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit për dhënien e informacioneve për veprimtaritë e paligjshme në mjediset pyjore, me shoqërinë civile dhe organizatat e ndryshme, duke angazhuar dhe përfshirë komunitetin për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor në pronësi të bashkisë.

8. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me programet dhe dokumentet strategjike për zhvillimin, ruajtjen dhe administrimin e fondit pyjor kombëtar, me vendim të kryetarit të bashkisë, strukturave komunitare mund t'u jepen detyra të caktuara për përdorimin e pyjeve, kujdesin dhe ruajtjen e tyre.

Neni 17 - Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet

1. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ka këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin tërësor të fondit pyjor kombëtar, publik e privat, brenda kufijve administrativë të bashkisë;
- b) ngre dhe mirëmban regjistrin e fondit pyjor kombëtar në bashki. Mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private, përgjigjet për ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor dhe mban të dhëna të sëmudjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyjet e bashkisë e ato private, brenda territorit administrativ të bashkisë;
- c) harton, miraton, zbaton dhe kontrollon ecurinë sipas planeve operacionale, në përputhje me dokumentet e planifikimit strategjik dhe planet e mbarështimit, për fondin pyjor publik e privat, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për mjedisin, si dhe administron të gjithë dokumentacionin përkatës;
- ç) përgatit projektet për investimet në pyje, kontrollon dhe merr në dorëzim punimet e kryera në pyje, pavarësisht nga burimi i financimit, mbështet dhe miraton planifikimin e zbatimit e qeverisjes në pyjet private;
- d) monitoron mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor publik; dh) drejton dhe mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e



erozionit, të rrëshqitjeve dhe ortekëve brenda territorit të bashkisë, si dhe luftën ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve;

e) siguron mbështetje teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të përdoruesve të pyjeve publike dhe organizatave të tyre, si dhe organizon trajnime dhe ofron shërbim këshillimor për ta në përputhje e në respektim të barazisë gjinore;

ë) bashkëpunon për zhvillimin e veprimtarive kërkimore në pyje dhe mbikëqyr zhvillimin e florës e të faunës së egër dhe propozon mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik;

f) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe organizatat e ngritura mbi baza ligjore me objekt të tyre "pyllin", si dhe garanton gjithëpërfshirjen e popullsisë lokale për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor që ka në pronësi;

g) kontrollon dhe realizon proceset inspektuese për zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, duke përfshirë veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, mbikëqyr zbatimin e kushteve të lejeve, licencave dhe detyrimeve kontraktuale nga ana e tyre, si dhe propozon tek institucioni përgjegjës pezullimin dhe shfuqizimin e tyre.

2. Strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale, duke realizuar përgjegjësitë e mëposhtme:

a) kontribuojnë për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar në përdorim të komunitetit rural;

b) nxisin zhvillimin e agropylltarisë në pjesë/zona të përshtatshme të fondit pyjor kombëtar;

c) mundësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin me strukturat përgjegjëse për pyjet në nivel qendror, rajonal dhe ato në bashki për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të mbarështimit të pyjeve në afërsi të fshatit;

ç) ndihmojnë në ndërgjegjësimin e komunitetit rural për rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe ekuilibrave biologjikë në to, si dhe orientojnë përdorimin e pyjeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe planet e mbarështimit;

d) sinjalizojnë dhe bashkëpunojnë me strukturat kontrolluese dhe monitoruese për parandalimin dhe ndëshkimin e aktiviteteve të paligjshme që dëmtojnë pyjet.

Neni 25 - Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar

1. Pjesë të fondit pyjor publik jepen në shfrytëzim/përdorim për zhvillimin e veprimtarive për:

a) qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore;

b) mbarështimin e florës dhe të faunës së egër, kultivimin dhe grumbullimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë, akuakulturës, kullotjen e blegtorisë, kositjen e barit dhe zhvillimin e gjuetisë;



2. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki identifikojnë dhe shpallin listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 30 - Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar

1. Mbrojtja e pyjeve përfshin masat parandaluese, vëzhgimin e situatës në pyje dhe evidentimin e dëmeve apo sinjalizimin e pranisë së faktorëve dëmtues, rikuperimin e dëmeve dhe rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara si pasojë e faktorëve dhe fenomeneve, që cenojnë dhe dëmtojnë fondin pyjor kombëtar, të tilla si:

- a) prerjet ose kullotja pa leje, dëmtimi i fondit pyjor kombëtar (përfshirë infrastrukturën pyjore dhe veprat ujore), sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi;
- b) lëndët e gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit;
- c) çdo veprimtari që cenon ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore, ose dëmton të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, e realizuar nga cilido institucion shtetëror, qendror apo vendor, personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj.

2. Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, është detyrë e përhershme e strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel qendror dhe vendor, e pronarëve privatë, e subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe, sipas rastit, edhe e strukturave të tjera shtetërore të ngarkuara nga ligje të tjera.

3. Ndalohet ndezja e zjarreve në fondin pyjor kombëtar, publik apo privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre.

4. Për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor kombëtar:

- a) strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zona të mbrojtura, si dhe pronarët private organizojnë sistemin e vrojtimit-sinjalizimit duke zbatuar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit të fuqi për mbrojtjen civile dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe pronarët privatë, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile;
- c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, detyrohen sipas ligjit



përkatës për mbrojtjen civile të garantojnë mbrojtjen nga zjarret në këto sipërfaqe, duke hartuar/përditësuar planet për mbrojtjen e tyre nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë dhe prefekturës, si edhe detyrimin për rregulloret e brendshme të tyre;

ç) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki organizon çdo vit fushata informimi, sensibilizimi dhe trajnimi për parandalimin e zjarreve në pyje. Këto fushata organizohen në nivel kombëtar edhe nga ministria dhe agjencia.

5. Për shuarjen e zjarreve në pyje:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, komunitetet lokale dhe pronarët privatë ngrenë njësi të posaçme dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me strukturat e tjera shtetërore sipas detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, përdoruesit e pyjeve përmes përfaqësuesve të tyre lokalë dhe pronarët privatë mbajnë të dhëna statistikore për zjarret në pyjet brenda territoreve të tyre dhe raportojnë pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet;

b) shpenzimet për shuarjen e zjarreve përballohen nga struktura ose subjekti që ka në pronësi pyllin dhe nga buxheti i shtetit në rastin e një prone me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

6. Për masat e mbrojtjes së pyjeve nga rreziku i zjarrit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

7. Në rast konstatimi të pranisë së sëmundjeve e dëmtuesve ose dëmtimit të pyjeve nga shkaqe të tjera:

a) të gjitha subjektet që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, duhet të njoftojnë menjëherë strukturën përgjegjëse për pyjet dhe agjencinë;

b) strukturat përgjegjëse për pyjet, kur vërejnë se bimët dhe prodhimet pyjore janë të infektuara nga parazitë karantinorë dhe janë kryer shkelje të kuadrit ligjor në fuqi, bëjnë menjëherë bllokimin dhe njoftojnë jo vetëm pronarin ose përdoruesin, por edhe eprorët për arsyet e bllokimit;

c) shpenzimet e luftimit të sëmundjeve, dëmtuesve dhe insekteve në fondin pyjor kombëtar, në rastet e dëmtimeve masive, përballohen nga buxheti i shtetit.

8. Për mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar ndalohet kullotja:

a) në zonat e mbrojtura, me përjashtim të rasteve kur ligji për zonat e mbrojtura lejon kullotjen dhe kalimin e kafshëve në këto zona;

b) në pyllëzimet e reja dhe në sipërfaqet me pyje të ulëta të ricunguara;

c) në grumbujt pyjorë që kanë arritur moshën e pjekurisë, ku pritet të arrihet ripërtëritja natyrale;

ç) në pyjet e shfrytëzuara ose në shfrytëzim e sipër deri sa të jetë bërë ripërtëritja natyrale e tyre.

9. Kriteret dhe rregullat për kullotjen në pyje përcaktohen me udhëzim të ministrit.



LIGJ Nr. 64/2012 PËR PESHKIMIN

Neni 5 - Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit ujqor dhe gjallesave të tyre

1. Shfrytëzimi, në harmoni me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe social, i burimeve të gjallesave të ujërave detare dhe ujërave të brendshme duhet të arrihet nëpërmjet:

- a) zbatimit, në mënyrë të kujdesshme, të masave që synojnë mbrojtjen dhe konservimin e burimeve të gjallesave ujore, duke ruajtur diversitetin biologjik;
- b) minimizimit të ndikimit të aktivitetit të peshkimit në ekosistemin ujqor;
- c) zbatimit të një qasjeje me kujdesin maksimal për ruajtjen e ekosistemit gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit;
- ç) zbatimit të përpiktë dhe racional të aktivitetit të peshkimit, në kuadër të një sektori peshkimi konkurrues dhe ekonomikisht të vlefshëm, duke u mundësuar një standard të drejtë jetese personave që ushtrojnë aktivitetin e peshkimit, si dhe nëpërmjet marrjes në konsideratë të interesave të konsumatorëve;
- d) zbatimit të qasjes së kujdesshme ndaj menaxhimit të peshkimit, nëpërmjet marrjes së masave menaxhuese për konservimin dhe mbrojtjen e llojeve objekt peshkimi, shoqëruese apo të varura, dhe llojeve jo objekt peshkimi, dhe mjedisit të tyre, pavarësisht se mund të mos ketë një informacion të mjaftueshëm shkencor për to;
- dh) vendosjes së parimeve të zhvillimit të aktiviteteve të përgjegjshme të peshkimit;
- e) marrjes parasysh të mendimit të institucioneve shkencore të specializuara gjatë procesit të vendimmarrjes prej autoriteteve kompetente.

Neni 40 - Autorizimi për peshkimin çlodhës/argëtues

1. Individët, vendas dhe/ose të huaj, që ushtrojnë peshkimin çlodhës/argëtues, përveç atyre që marrin pjesë në peshkimin sportiv, pajisen me autorizim peshkimi.
2. Lloji, numri maksimal i autorizimeve për çdo komunë/bashki/qark, gjatë një viti kalendarik, si dhe kriteret që duhen përmbushur për lëshimin/marrjen e autorizimit të peshkimit përcaktohen nga ministri.
3. Për peshkimin amator, institucionet që verifikojnë plotësimin e kriterëve të lejimit, janë organet e pushtetit vendor.
4. Kriteret, që duhet të përmbushë një mjet lundruar për t'u konsideruar si mjet turistik, përcaktohen nga autoritetet klasifikuese të përcaktuara në legjislacioni përkatës.
5. Autorizimi për peshkimin amator lëshohet nga autoriteti përgjegjës i qeverisjes vendore. 6. Autorizimi për peshkimin turistik lëshohet nga ministria ose çdo ent tjetër i autorizuar prej saj.

LIGJI Nr.10253, datë 11.3.2010 "PËR GJUNETINË"

Ndryshuar me ligjin Nr.43/2013

Neni 12 - Propozimi i zonës së gjuetisë

Funded by
the European Union



1. Drejtoritë e shërbimit pyjor, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, studiojnë dhe propozojnë zonat e gjuetisë në shkallë vendi, duke i paraqitur propozimin me materialet përkatëse ministrisë.

Materialet përmbajnë:

- a) të dhëna mbi sipërfaqen, shtrirjen dhe kufijtë e saj;
 - b) hartën dhe skicat për planvendosjen;
 - c) mendimin e njësive të qeverisjes vendore, në territoret e të cilave shtrihet zona që propozohet dhe të shoqatave të gjuetarëve.
2. Në përgatitjen e propozimit për shpalljen e zonave të gjuetisë zbatohen kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

3. Zonat e gjuetisë miratohen me urdhër të veçantë të ministrit.

Neni 14 - Shpallja e zonës së gjuetisë

1. Ministria, brenda 5 ditëve nga miratimi i ministrit, shpall zonën e gjuetisë, duke njoftuar me shkrim DSHP-në që ka bërë propozimin, organet e qeverisjes vendore ku ndodhet zona, si dhe shoqatën e gjuetarëve.

Neni 54 - Monitorimi i gjuetisë

3. Strukturat menaxhuese të pyjeve dhe kullotave, policia pyjore, njësitë tekniko-organizative të qeverisjes vendore, menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe shoqatat e gjuetarëve ndjekin në vijimësi zhvillimin e gjuetisë, duke nxjerrë të dhënat, sipas treguesve të përcaktuar në programin e monitorimit të gjuetisë.

Neni 57 - Organet e kontrollit

1. Organi i specializuar i kontrollit për zbatimin e këtij ligji është policia pyjore, në bashkëpunim me menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe me organet e kontrollit të njësive të qeverisjes vendore.



G. IPOULLAS.
URRANIMITIKU
03/11/2023



Nr. 3705/3/1701
Dt 20.11.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK



Nr. 939/10 Prot.

Lezhë, më 11 2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 54 gërma "k" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 25, datë 03.11.2023 të Këshillit të Bashkisë Mirditë "Për miratimin e rregullores për menaxhimin e parqeve dhe hapësirave publike, bashkia Mirditë".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

